

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5809
E hënë, 24 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Edhe 100 gjykata speciale le t'i bëjnë, lufta çlirimtare nuk do të mund të njolloset

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ILIR MURTEZAJ ■ FAQE 8

ATK-ja inkasoi 212.3 milionë euro


Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka bërë me dije se të hyrat e këtij institucioni për periudhën janar-maj të këtij viti janë 212.3 milionë euro që, në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, janë rreth 18.7 milionë euro më shumë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kanë zhvilluar rreth 127 aktivitete të konfiskimit të pasurisë që, si rrjedhojë, janë inkasuar mbi 2.6 milionë euro. Murtezaj ka thënë se nuk është i mjaftueshëm numri i inspektorëve që ka ATK-ja. Ai ka bërë me dije se kanë bërë kërkesë për rritjen e numrit të inspektorëve. Murtezaj ka treguar se me ardhjen e tij në krye të ATK-së janë zhvilluar një mori aktivitete në drejtim të reformave brenda këtij institucioni



OPINION

BISEDË ME HISTORINË DHE ME DËSHMORIN E KOMBIT BASRI CANOLLIN F. 9

Prof. dr. Emin KABASHI



AKTUALE

KOSOVA PO TREGON MUNGESË TË KAPACITETEVE PËR ABSORBIM TË FONDEVE TË BE-së F. 7

EKONOMI



KOSOVËS PO I IK FUQIA PUNËTORE F. 5

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR SHËRBIME KËSHILLIMORE TË RISTRUKTURIMIT TË TELEKOMIT F. 6

SPORT

MAJLINDA E HISTORISË F. 10



Qeveria pritet t'i ketë vetëm 15 ministri ■ FAQE 4



Republika e Kosovës në të ardhmen nuk do t'i ketë më shumë se pesëm-bëdhjetë ministri dhe tridhjetë zëvendësministra në rast se do të miratohet Ligji për qeverinë. Ky ligj i cili pritet të aprovohet gjatë këtij viti parasheh zvogëlim të numrit të ministrave, zëvendësministrave dhe

zëvendëskryeministrave. Analistët politikë e mirëpresin miratimin e këtij ligji, por shprehin skepticizëm se mund të zbatohet në praktikë. Politologu Belul Beqaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se një racionalizim i qeverisë është i domosdoshëm ■ FAQE 3

Pas dështimit të Samitit të Parisit nuk dihet se kur do të vazhdojë dialogu Kosovë - Serbi

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Basha: Nuk ka zgjedhje më 30 qershor

TRANË, 23 QERSHOR - "Zgjidhja e krizës politike nuk mund të kalojë nëpërmjet një pazari mes palësh", thalideri i PD-së, Lulzim Basha, në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë". Sipas tij, "nuk mund të ketë zgjidhje të krizës pa drejtësi dhe pa i dhënë fund pandëshkueshmërisë së politikanëve të lidhur me krimin që kanë vjedhur zgjedhjet". "Me largimin nga parlamenti dhe dorëzimin e mandateve zbuluam para botës se parlamenti dhe qeveria nuk janë produkt i votës së popullit, por i shkrijës në një të qeverisë, partisë në pushtet dhe krimin të organizuar", u shpreh Basha. Sipas tij, "ftesat për dialog që bëhen sa për

sy e faqe dhe për propagandë janë përpjekje për t'iu hedhur hi syve njerëzve".

Basha nënvizoi se "përgjimet e 'Bild'-it faktuan skemën për mbajtjen e pushtetit në mënyrë ilegjitime: zgjedhjet janë vjedhur në të gjithë territorin, me të gjitha metodat". Ai tha se asgjë nuk do ta zgjidhë këtë krizë pa u ndëshkuar hajdutët e votave, kriminelë apo politikanë.

Basha theksoi se "30 qershori nuk është një datë zgjedhjesh. Nuk mund të ketë zgjedhje pa opozitën dhe me 1 kandidat. Në 30 qershor ka një tentativë të një partie të kriminalizuar, që ka braktisur interesin publik dhe që i shërben

vetëm karriges, pushtetit dhe pasurimit të kupolës së saj".

"Shqipërisë i refuzohet prej tre vjetësh hapja e negociatave, sepse nuk përmbush detyrat në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Shqipëria nuk ka bërë hapa përpara, por ka bërë hapa pas", tha Basha.

"Evropa nuk është kundër shqiptarëve. Evropa është kundër drogës, kundër qeveritarëve të korruptuar. Nuk shkohet në Evropë pa vlerat evropiane të zgjedhjeve të lira e të ndershme, pa drejtësi me një standard për të gjithë, pa i dhënë fund pandëshkueshmërisë së politikanëve", deklaroi Basha.



Dilema mbi efikasitetin e Qeverisë së Maqedonisë Veriore pas reformatimit

Kryeministri Zoran Zaev kohë më parë i ka paralajmëruar ndryshimet në qeveri për shkak të pakënaqësive dhe synimit për rritjen e efikasitetit në punë, por mbetet të shihet nëse këto ndryshime do të sjellin efekte pozitive në punën e ekzekutivit



siguri nën presionin e emocioneve po bëhen edhe ndryshimet e para në qeverinë e kryeministrit Zaev. Të përballur me dobësi të caktuara, por edhe me marrëveshjet si ajo me Greqinë dhe Bullgarinë, konsideroj se qeveria tani është në kërkim të ideve të reja, të njerëzve të rinj që me energji të reja ta vazhdojnë punën e mëtejme të qeverisë", thotë Ruzhin, duke shprehur besimin e vazhdimin të kursit të

reformave të nevojshme, para së gjithash, për integrimin evropian.

Por, Naser Zyberi, njohës i çështjeve politike dhe ish-deputet në disa përbërje parlamentare, nuk pret ndonjë rezultat konkret nga reformatimi i qeverisë. Ai thotë se koha nuk është e mjaftueshme për të pritur ndryshime në funksionimin më efikas të qeverisë. Ai thotë se rezultatet e fundit të zgjedhjeve

presidenciale ishin një mesazh i qartë se qytetarët nuk janë të kënaqur me punën e qeverisë. Partitë në pushtet, 31 gjithsej, me një dallim të ngushtë fituan opozitën, e cila garoi e vetme në zgjedhje. "I shtyrë nga ky presion, kryeministri është i detyruar ta bëjë reformatimin e qeverisë, por edhe kjo nuk ka ndonjë garanci se do të japë rezultate të kënaqshme dhe të prekshme, por do të jetë një amortizues i këtij opinioni negativ që është krijuar ndaj kësaj strukture qeverisë dhe me këtë, së paku, do të tentojë ta ndryshojë imazhin dhe perceptimin e qytetarëve, e jo se do të ketë ndonjë rezultat konkret", thotë Zyberi.

Ai thekson nevojën për punë më efikase të qeverisë, e cila, sipas tij, mund të ishte bërë edhe pa reformatimin e saj. "Vendi ka nevojë për rezultate të prekshme, në planin e integritimit evropian, në NATO dhe në planin ekonomik. Nëse kjo nuk arrihet, reformatimet do të jenë vetëm një shtyrje e një letargjie që mund të ketë rezultat të humbjes së zgjedhjeve", thekson Zyberi.

SHKUP, 23 QERSHOR - Qeveria e Maqedonisë së Veriut në dyvjetorin e mandatit po i nënshtrohet reformatimit të parë apo ndërrimit të jo më shumë se tetë ministrave, si të Bujqësisë, Kulturës, Ekologjisë, të Pushtetit Lokal, ministrave pa resor dhe të emërimit të një kuadri në Ministrinë e re për Sistem Politik dhe Marrëdhënie mes Bashkësive.

Kryeministri Zoran Zaev kohë më parë i ka paralajmëruar ndryshimet për shkak të pakënaqësive dhe synimit për rritjen e efikasitetit në punë. Por, krejt këto ndryshime sa do të sjellin efekte pozitive në punën e ekzekutivit?

Njohësit e çështjeve politike kanë qëndrime të ndryshme, disa prej të cilëve reformatimin e shohin edhe si veprim normal

që ndodh në gjysmën e mandatit të qeverive, ka njoftuar rfe. "Në të gjitha demokracitë është praktikë që në gjysmën e mandatit të bëhen freskime të caktuara, diku më pak e diku edhe më shumë. Është një periudhë e mjaftueshme kohore për t'i parë dobësitë apo punën e bërë nga çdo anëtar i Qeverisë. Kjo tani ndodh edhe me kabinetin e kryeministrit Zaev dhe mbetet të shihet nëse ndryshimet do të sjellin ose jo efikasitet në punën e qeverisë", thotë Ruzhin duke theksuar edhe faktin se për dallim nga vendet e tjera, Maqedonia e Veriut është përballur me sfida të shumta që edhe mund ta kenë lëkundur funksionimin e qeverisë. "Gjatë kësaj periudhe në Maqedoninë e Veriut janë bërë ndryshime, të cilat ishin edhe euforike dhe me

Socialistët nuk tërhiqen nga e drejta e tyre

TRANË, 23 QERSHOR - Koha kur socialistët tërhiqeshin përballë presioneve dhe kërcënimeve të Partisë Demokratike ka përfunduar. Kryeministri Rama, gjatë takimit me përmetarët në vijim të fushatës elektorale, tha se socialistët nuk do të bëjnë asnjë milimetër mbrapa në rrugën e tyre e të heqin dorë nga e drejta e tyre. "Ky nuk është një film i ri. Ne e kemi para 30 vjet këtë film me

Saliun që u mësua të besonte se socialistëve ua merr gjerat me forcë, se socialistët janë njerëz normalë, janë njerëz që dëgjojnë mendjen dhe hapi rrugë budallait, kështu që turru dhe socialistët hapin rrugë. Mirëpo, ja që kjo histori ka mbaruar. Koha kur socialistët mund të merreshin përpara si dele nga çeta qoftë me armë, apo qoftë me molotovë, qoftë me ulërima, me dhëmbë të

ndryshkur që kërcëllinin, qoftë me kërcënime, ka mbaruar. Është tjetër kohë dhe është një Parti Socialiste që ta kthen si ta duash, sy për sy e dhemb për dhemb, kur ta duash dhe ku ta duash. Po, që socialistët të bëjnë një milimetër mbrapa në rrugën e tyre dhe të heqin dorë nga e drejta e tyre, kjo nuk bën më vaki kurrë", theksoi kryeministri Rama.



Pas dështimit të Samitit të Parisit nuk dihet se kur do të vazhdojë dialogu Kosovë - Serbi

Pas dështimit të Samitit të Parisit nuk dihet se kur do të vazhdojë procesi i dialogut Kosovë - Serbi. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se partnerët ndërkombëtarë tani kanë filluar ta drejtojnë gishtin në drejtim të Kosovës për dështimin e këtij Samiti dhe vazhdimin e dialogut në mes të dy shteteve. Ai ka theksuar se ngërçi në dialog dhe anulimi i Samitit të Parisit për të dy vendet, Kosovën dhe Serbinë, shënon hap mbrapa për të ardhmen evropiane. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se ishte gabim që sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës të paraqitej si pjesë e dialogut me Serbinë



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Iniciativa e kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit francez Emanuel Macron për një takim në Paris në përpjekje për t'i zhbllokuar bisedimet ndërmjet Kosovës e Serbisë tashmë ka dështuar. Ndonëse ende nuk dihen arsyet e mosmbajtjes së këtij takimi që pritej të ndodhte më 1 korrik, liderët institucionalë të Kosovës janë përplasur për këtë çështje.

Presidenti Hashim Thaçi, pasi ka marrë konfirmimin nga ndërkombëtarët, se ky takim nuk do të mbahet, ka thënë se veprimet e nxituara dhe të gabuara strategjikisht të institucioneve të Kosovës kanë dëmtuar rëndë respektin dhe mbështetjen e partnerëve për Kosovën. "Nga

partnerët evropianë u informova se pas përpjekjeve të shumta për sukses, Samiti i Parisit, si vazhdim i atij në Berlin, definitivisht nuk do të mbahet. Ishte planifikuar vazhdimi i dialogut Kosovë - Serbi, i udhëhequr nga BE-ja, me mbështetjen unike dhe të fortë franceze-gjermane. Vendimet dhe veprimet e nxituara, të pakoordinuara dhe të gabuara strategjikisht të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, kanë dëmtuar rëndë respektin dhe mbështetjen e partnerëve tanë perëndimorë për Kosovën", ka shkruar presidenti në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, tani ndërkombëtarët e bëjnë përgjegjëse Kosovën për bllokimin e dialogut në mes të dy vendeve. "Si rrjedhojë, partnerët tanë ndërkombëtarë, fatqësisht, sot e mbajnë Kosovën përgjegjëse për bllokimin e dialogut, për

dështimin e takimit të paraparë në Paris dhe për prolongimin e vendimit për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë. Dështimi i procesit të filluar në Berlin dhe anulimi i Samitit të Parisit përbëjnë çaste reflektimi për aktorët vendorë dhe faktorët ndërkombëtarë udhëheqës dhe mbështetës të procesit të dialogut për normalizim dhe pajtim në mes të shteteve dhe popujve tanë. Ngërçi në dialog dhe anulimi i Samitit të Parisit për të dy vendet, Kosovën dhe Serbinë, shënon hap mbrapa për të ardhmen evropiane", ka shkruar Thaçi, duke i bërë thirrje BE-së dhe ShBA-së që të mos i ndalin përpjekjet e tyre për rifillimin e dialogut dhe arrijten e marrëveshjes paqësore.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka vlerësuar se ishte gabim që sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës të paraqitej si pjesë e dialogut me Serbinë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se është vënë në mbrojtje të shtetësisë së Kosovës. "Ishte gabim që sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës të paraqitej si pjesë e dialogut me Serbinë. Mbrojtja e këtyre shtyllave të shtetit ka një çmim dhe sot populli i Kosovës është krenar që këto i ka prapë të pacenuara. Dëmi që i është shkaktuar Kosovës, duke bërë pazar me sovranitetin dhe integritetin, është i madh, por bashkë jemi vënë në mbrojtje të shtetësisë, integriteteve euroat-

lantike dhe zhvillimit ekonomik", ka shkruar Haradinaj. Procesi i bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka mbetur i bllokuar që nga nëntori i vitit të kaluar, kur Qeveria e Kosovës vendosi tarifën prej 100 përqindësh ndaj mallrave serbe si kundërpërgjigje ndaj qasjes së Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës. Udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë pritet të marrin pjesë në një takim të lartë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili pritet të mbahet nga 3 deri më 5 korrik në Poznan të Polonisë. Ende nuk dihet nëse në kuadër të këtij Samiti do të ketë ndonjë takim mes udhëheqësve të Kosovës dhe Serbisë.

Haradinaj: Edhe 100 gjykata speciale le t'i bëjnë, lufta çlirimtare nuk do të mund të njolloset

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, është i bindur që partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, nuk janë të gatshme të shkojnë në zgjedhje pasi nuk i kanë punët mirë në terren. Ai ka thënë se i vetmi subjekt politik që është i gatshëm të shkojë në zgjedhje është AAK-ja dhe se janë shumë afër për të qenë subjekti i parë politik.

Haradinaj në një intervistë për "Kosovapress" ka folur edhe për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Gjykatën Speciale, listat e veteranëve dhe për partitë e tjera.

Deputeti Haradinaj ka thënë se

rezultatet e punës së qeverisë aktuale janë të prekshme, ndërsa thotë se detyrë e opozitës është që të kritikojë. Ai ka thënë se derisa opozita nuk e ka shumicën, koalicioni qeverisës është stabil. Sa i përket dialogut me shtetin serb, deputeti Haradinaj ka thënë se me Serbinë mund të flasim vetëm për njohje reciproke. Sipas tij, temat e brendshme të Kosovës janë të Kosovës dhe nuk ka çfarë të diskutohet me shtetin serb. Gjykatën Speciale vazhdon ta shohë si vendim politik, ndërsa ka thënë se nuk ka marrë ftesë për t'u intervistuar nga kjo gjykatë.

Deputeti Haradinaj ka theksuar se të gjithë që kanë qenë në luftë kanë kryer detyrën e shenjtë për



lirinë e vendit dhe duhet të ndihen krenarë. Në këtë kontekst,

deputeti Haradinaj ka thënë se edhe 100 gjykata po të bëhen

nuk mund ta njollosin luftën çlirimtare të Kosovës.

Këtë vit pritet të miratohet Ligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Qeveria pritet t'i ketë vetëm 15 ministri

Republika e Kosovës në të ardhmen nuk do t'i ketë më shumë se pesëmbëdhjetë ministri dhe tridhjetë zëvendësministra në rast se do të miratohet Ligji për qeverinë. Ky ligj, i cili pritet të aprovohet gjatë këtij viti, parasheh zvogëlim të numrit të ministrave, zëvendësministrave dhe të zëvendëskryeminstre. Analistët politikë e mirëpresin miratimin e këtij ligji, por janë skeptikë se mund të implementohet në praktikë. Politologu Belul Beqaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se një racionalizim i qeverisë është i domosdoshëm

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Qeveria e Republikës së Kosovës aktualisht është një prej qeverive më të mëdha në Evropë e cila përbëhet nga gjithsejtë njëzetë ministri, pesë zëvendëskryeministria si dhe rreth tetëdhjetë zëvendësministra. Përveç numrit të madh të ministrave dhe zëvendësve të tyre, qeveria aktuale ka numër të madh edhe të këshilltarëve politikë. Por numri i ministrave, zëvendësministrave dhe zëvendëskryeminstre pritet të ulet në rast se do të miratohet Ligji për qeverinë këtë vit. Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se Ligji për qeverinë është gati dhe aktualisht janë në konsultime të brendshme. Ai ka shprehur optimizëm se gjatë këtij viti do të miratohet ky ligj. "Tash po e trajtojmë me juristë dhe profesionistë sanksionimin e numrit të dikastereve qeveritare në kuadër të këtij ligji. Pastaj ligji do të dalë në diskutim publik dhe shumë shpejt besoj do të miratohet në Kuvend. Ligji për qeverinë e përcjell logjikën e modeleve ndërkombëtare të ministrive kryesore", ka thënë Tahiri. Ai ka treguar se me Ligjin për qeverinë nuk duhet të ketë më shumë se 15 ministri dhe do të ketë jo më shumë se 30 zëvendësministra. Sipas Tahirit, nuk do të ketë as zëvendëskryeministria me portofol. "Do të thotë, kemi bërë një analizë krahasuese të vendeve evropiane që janë të ngjashme me Kosovën dhe kanë dalë nëntë ministri më kryesore dhe jemi duke i organizuar dikasteret në mënyrë që Qeveria e Republikës së Kosovës mos të ketë më shumë se 15 ministri. Me këtë ligj qeveria do të ketë jo më shumë se dy zëvendëskryeminstre

dhe secili zëvendëskryeministër do ta ketë detyrën e vet të sanksionuar si dhe do të ketë zëvendëskryeministria me portofol, pra nuk do të ketë zëvendëskryeministria pa portofol. Përveç kësaj, në Ligjin për qeverinë i kemi identifikuar të metat përgjatë viteve të cilat i kemi sanksionuar me nene duke e penguar potencialisht keqpërdorimin e detyrës zyrtare e cila do të mund të ndodhte në mungesë të një ligji të saktë. Ndër vite kemi pasur një numër të madh të lëvizjeve sa i përket numrit të ministrive dhe kemi parë se në mungesë të një ligji rregulloret kanë ndryshuar hap pas hapi", ka thënë Tahiri. Përveç zvogëlimit të numrit të ministrive, ky ligj parandalon ushtrimin e funksioneve të tjera të kryeministrit dhe ministrave. "Ky ligj në radhë të parë e parandalon ushtrimin e funksioneve të tjera të kryeministrit dhe ministrave. E parandalon vendim-marrjen në kohë të fushatave zgjedhore, pastaj deri në esencë e shpjegon procesin e konsultimit dhe transparencës dhe, mbi të gjitha, e vendos tavanin, respektivisht e saktëson numrin e ministrive, të zëvendësministrave dhe e riorganizon portofolin në bazë të sektorëve të vet. Për shembull, aktualisht ka shumë ministri që merren me ekonominë, kurse me këtë ligj do të jetë një ministri që do ta ketë sektorin e ekonomisë, tregtisë, investimeve strategjike dhe kështu me radhë. Ky ligj përmirëson efikasitetin dhe funksionalitetin e ekzekutivit", ka deklaruar Tahiri, duke shtuar se Ligji për qeverinë do të miratohet këtë vit. "Viti 2019 Kosovën do ta gjejë me Ligjin për qeverinë i cili do të jetë model edhe për rajonin. Me këtë rast i falënderoj të gjithë ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë që kanë qenë pjesë e procesit të hartimit të këtyre ligjeve, në veçanti të



Ligjit për qeverinë. Ligji për qeverinë do të duhej të merrte 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës sepse është ligj që u përshtatet të gjithëve", është shprehur Tahiri. Analistët politikë e mirëpresin miratimin e këtij ligji, por janë skeptikë se mund të zbatohet në praktikë. Politologu Belul Beqaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se një racionalizim i qeverisë është i domosdoshëm. "S'do mend se një racionalizim i Qeverisë ka qenë i domosdoshëm. Nuk mund të prej-udikoj epilogun por, besoj se është krijuar një vetëdije e përgjithshme se kjo çfarë po

ndodhë me qeverinë Haradinaj është keqpërdorim flagrant i parasë publike", ka shprehur Beqaj. Megjithatë, bazuar në përvojën e deritanishme, ai ka vlerësuar se nuk përjashtohet mundësia që Ligji për qeverinë të mos aprovohet fare. Nëse veç ndodhë një gjë e tillë, ai ka thënë se kjo tregon se në çfarë niveli është vetëdija jonë politike dhe kombëtare. "Nuk e përjashtoj edhe këtë, ngase ne jemi popull që jemi në gjendje që me dhjetëra herë t'i përsërisim gabimet e njëjta, por kjo vetëm sa tregon se në cilin nivel është vetëdija politike dhe kombëtare", ka deklaruar

ar Beqaj. Mirëpo numri i madh i dikastereve qeveritare, përveç që është kritikuar nga partitë opozitare në vend dhe nga shoqëria civile, ka marrë kritika edhe nga faktori ndërkombëtar. Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të opozitës në vazhdimësi gjatë këtyre gati dy vjetëve të qeverisjes kanë vlerësuar se numri i madh i zëvendëskryeminstre, ministrave, zëvendësministrave dhe këshilltarëve politikë është bërë për t'i rehatuar militantët e partive politike dhe jo për ta rritur efikasitetin e qeverisjes në shërbim të qytetarëve.

Kosova po tregon mungesë të kapaciteteve për absorbim të fondeve të BE-së

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Kryetari i Bordit Ekzekutiv të Institutit EPIK, Taulant Kryeziu, ka kritikuar institucionet e Kosovës për humbjen e dhjetëra milionë eurove të fondeve të BE-së. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se mesazhi i kësaj që po ndodh është se institucionet e Kosovës janë duke treguar nivel të paprecedent të mungesës së kapaciteteve për absorbimin e fondeve të BE-së në Ballkan. "Vitin e kaluar humbën 43 milionë fonde të BE-së. Së fundi edhe 12 milionë të tjera. Ndërsa, 25 milionë të tjera janë të rrezikuara për shkak të politizimit të skajshëm të bordeve të ndërmarrjeve publike, institucioneve të pavarura dhe shërbimit civil dhe diplomatik. Pra, kanë humbur, ose janë të rrezikuara nga humbja, 80 milionë euro. Për ta vizualizuar ndikimin e kësaj, me këto mjete kemi mundur të dërgojmë në studime jashtë vendit së paku 200 vajza dhe djem të rinj ose 80 ndërmarrjeve t'ua ofrojmë

nga një milion euro për ta rritur kapacitetin prodhues, me synimin e gjenerimit të vendeve të reja të punës", ka thënë Kryeziu.

Ai ka theksuar se mesazhi i kësaj që po ndodh është i thjeshtë dhe i qartë. "Institucionet e Kosovës janë duke treguar nivelin e paprecedent të mungesës së kapaciteteve për absorbimin e fondeve të BE-së në Ballkan. Me fjalë të tjera, jo që s'po i bëjmë reformat, por as paratë falas që po na ofrohen nuk po dimë t'i shpenzojmë.

Rasti i fundit për humbjen e fondeve nga BE-ja ishte më 7 qershor të këtij viti. Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë i është dashur të anulohet një projekt prej 12 milionë eurosh për ndërtimin e deponisë së mbeturinave të rrezikshme në Kosovë. Ky projekt përfshinte ndërtimin e objekteve për deponimin e mbeturinave të rrezikshme bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës në vitin 2010. Si rrjedhojë, projekti është përfshirë në të ashtuquajturin Instrument i BE-së për Ndihmën e Para-Anëtarësimin



(IPA) për 2015-n. Për ndërtimin, qeveria fillimisht kishte identifikuar një parcelë toke brenda kompleksit të vjetër ushtarak në Harilaq në Fushë-Kosovë, e cila, pas studimeve paraprake, nuk ka dalë të jetë e përshtatshme për shkak të

mjeteve të pashpërthyer dhe bunkerëve të vjetër, duke e bërë të pamundur ndërtimin. Pas disa kërkesave nga ana e BE-së në Kosovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kishte identifikuar një lokacion alternativ brenda

Komunës së Fushë-Kosovës. Megjithatë, Kuvendi Komunal i Fushë-Kosovës e pati refuzuar ngritjen e objektit në territorin e saj, duke mos i lënë kështu BE-së opsion tjetër, veçse ta anulohet projektin.

Kosovës po i ik fuqia punëtore

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Kushtet jo të mira për punë dhe pagesat e ulëta po e rrezikojnë tregun e punës në Kosovë i cili po zbrazet nga njerëz të profileve të ndryshme. I. K. (emër i njohur për redaksinë e Radios Evropa e Lirë) thotë të ketë qenë i punësuar në një kompani private për një vit, por e ka lëshuar vendin e punës dhe nuk dëshiron të punojë më në sektorin privat dhe askund në Kosovë për shkak, siç thotë ai, kushteve jo të mira të punës dhe pagës së ulët. "Kam punuar në një biznes tregtar në Ferizaj. Orari i punës ka qenë tetë orë, por ka ndodhur që kam punuar edhe më shumë dhe nuk jam kompensuar për punën jashtë orarit. Paga ka qenë e ulët, 250 euro në muaj. E kam lënë punën për shkak të kushteve dhe nuk kam pasur kontratë pune. Ka një vit që nuk punoj askund dhe nuk dua të punoj në një punë të tillë e cila nuk paguhet dhe nuk ofron kushte të mira për punëtorët", ka thënë I. K. Ai thotë se nuk e sheh Kosovën si vend ku do të mund të punësohet dhe të ketë një pagë dinjitoze dhe një punë me kushte më të mira. "Kam aplikuar për vizë pune në Kroaci dhe jam duke pritur të shkoj atje të punoj për shkak të pagës dhe kushteve më të mira

që ofron ai vend", ka thënë ai. Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, paga mesatare në sektorin privat në Kosovë është 384 euro, ndërsa në sektorin publik rreth 500 euro. Mungesën e punëtorëve në Kosovë e kanë theksuar edhe bizneset. Ata tani e sa kohë janë duke u ankuar se nuk po arrijnë të gjejnë punëtorë edhe përkundër shkallës së lartë të papunësisë në vend që, sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave, arrin në 26.9 për qind.

Bazuar në të dhënat e bizneseve, mungesa e punëtorëve është më e theksuar në sektorin e ndërtimit, në hotelieri dhe në disa sektorë ku punohen punë sezonale.

Brahim Selimaj nga Aleanca Kosovare e Biznesit dhe pronar i kompanisë ndërtimore "Elsa", e cila veprimtarinë e saj e zhvillon në Prishtinë dhe në Pejë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova po përballet me mungesë të punëtorëve. "Gjetja e fuqisë punëtore është bërë problem në Kosovë. Kjo ka ardhur si pasojë e mospërpjekjeve të autoriteteve që ta ndalin emigrimin e të rinjve nga vendi. Por, të rinjtë duhet të kuptojnë se edhe në Perëndim nuk është se ka një jetë më të mirë se në



vendin e tyre. Bizneset në Kosovë, po ashtu, nuk arrijnë të gjejnë punëtorë të kualifikuar. Për një punë të caktuar ka mungesë të kadrove në profile të ndryshme për shkak edhe të sistemit arsimor ku mungojnë profile çfarë kërkon tregu i punës", ka thënë Selimaj. Mungesa e punëtorëve, sipas përfaqësuesve të Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, ka ardhur si pasojë e ikjes së të rinjve nga vendi dhe kushtet jo të mira të punës. Jusuf Azemi, kryetar i kësaj Sindikate, thotë

për REL se mungesa e punëtorëve vetëm sa do të thellohet në të ardhmen.

Sipas një raporti të publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në Qeverinë e Kosovës, thuhet se për periudhën 2013-2017 mesatarisht në vit kanë emigruar deri në 35 mijë qytetarë të Kosovës dhe se pjesa dërrmuese e emigrimit kishte përfshirë grupmoshat e reja kryesisht 25-44 vjeç.

Ndërkaq sa iu përket aplikimeve për vizë, sipas të dhënave të Sistemit të

Informimit për Viza Shengen, brenda viteve 2014 - 2018 thuhet të jenë regjistruar mbi 400 mijë kërkesa të përgjithshme për viza.

Nga numri i përgjithshëm i aplikimeve për vizë Shengen, vendime pozitive apo viza të lëshuara janë rreth 80 për qind, kurse janë refuzuar vetëm 20 për qind e kërkesave të aplikantëve. Gjermania prin me numrin më të madh të kërkesave për viza, pasur nga Zvicra, Italia, Greqia, Hungaria, Sllovenia dhe shtetet e tjera.

Përkujtohet Refki Fekaj që kishte rënë në minat serbe në oborrin e shkollës

SKENDERAJ, 23 QERSHOR (ER) - Shkolla Fillore "Vëllezërit Frashëri" në fshatin Qubrel të Komunës së Skenderajt ka përkujtuar nxënësin Refki Ramdan Fekaj, i cili ka humbur jetën 20 vjet më parë nga minat, të cilat ishin vendosur nga forcat serbe në oborrin e kësaj shkolle. Në nderim të jetës së Refkiut kjo shkollë ka organizuar një ceremoni përkujtimore. Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë, përpos familjarëve, nxënësve, edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Fadil Beka, ish-komandanti i Brigadës 112 "Arben Haliti", Jetullah Geci, përfaqësues të Komunës së Skenderajt, drejtori i Shkollës Fillore "Vëllezërit Frashëri", Florim Rrustemi dhe mysafirë të tjerë.

Gjatë kësaj ceremonie është folur për jetën e Refkiut, sakrificën e familjes Fekaj dhe të popullit shqiptar në përgjithësi për liri dhe pavarësi. Po ashtu, gjatë kësaj ceremonie është mbajtur



edhe një program kulturor-artistik nga nxënësit e kësaj shkolle. Pas kësaj ceremonie, drejtori i shkollës "Vëllezërit Frashëri", Florim Rrustemi, ka rrëfyer ngjarjen se si ka rënë në mina Refkiu së bashku me shokët e vet. "Tre shokët e tij plagosen rëndë, ndërsa për Refkiun plaga ishte vdekjeprurëse. Ai ka jetuar tri ditë pas plagëve dhe ka vdekur në spitalin e Prishtinës",

ka treguar Rrustemi.

Refki Fekaj është përkujtuar edhe nga shoku i tij i klasës, Driton Sylja. Ai ka thënë se çdo ditë e kujton momentin kur ka rënë në mina shoku i tij, Refkiu. "Çdo ditë jetoj edhe eci përpara me kujtimin e asaj dite, duke u munduar t'i jetoj dy jetë: jetën time që ma ka falur Zoti dhe jetën për shokun tim i cili nuk pati fatin ta jetojë", ka thënë Sylja.



Edhe babai i Refkiut, Ramadan Fekaj, ka përkujtuar djalin e tij, i cili ishte më i vogli në familje. Ai ka thënë se gjatë gjithë luftës ka qenë bashkë me Refkiun, duke mos u ndarë në asnjë çast. Fekaj ka thënë se askush nuk e kishte menduar se serbët kishin vendosur mina në oborrin e shkollës. Babai i Refkiut ka thënë se pas përfundimit të luftës, djali i tij me shokët ka shkuar për ta viz-



ituar nga malli shkollën e fshatit ku dhe kanë rënë në minë. Ai ka thënë se falë gjakut të dëshmorëve dhe martirëve Kosova është duke i gëzuar frytet e lirisë.

Në oborrin e Shkollës Fillore "Vëllezërit Frashëri" gjendet pllaka përkujtimore kushtuar Refki Ramdan Fekajt, i cili kishte ndërruar jetë në moshën njëmbëdhjetëvjeçare.

Komuna e Skenderajt ofron lehtësira për çdo investitor

Skenderaj, 23 qershor (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nënkryetari Nuredin Lushtaku dhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kanë vizituar fabrikën "Adifix EPS", e cila merret me prodhimin e materialit ndërtimor. Kjo ndërmarrje ka filluar edhe një linjë të re prodhimi, atë të styroporit, e cila pritet ta nisë punën shumë shpejt pasi, pothuajse, është në kohën e fundit të pajisjeve të avancuara për prodhim. Me këtë rast, kryetari Jashari e ka lavdëruar familjen Bajraktari për investimet për ndërtimin e kësaj fabrike. "Është për t'u lavdëruar investimi i familjes së vyer e punëtore Bajraktari për hapjen e linjës së re të prodhimit të styroporit EPS. Përveç prodhimit të materialit ndërtimor, pritet që, përveç punësimit të një numri mesatar punëtorësh, produktet e prodhuara në këtë fabrikë të eksportohen edhe jashtë tregut të Kosovës. Gjatë vizitës, së



bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku dhe kryetarin e Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, në fabrikën 'Adifix' pamë se pajisjet e nevojshme tashmë janë thuajse të montuara dhe shpejt pritet prerja e shiritit, që shënon edhe fillimin e punës së fabrikës miliona euro investim", është shprehur Jashari.

Komuna e Skenderajt mirëpret çdo investim si nga jashtë, po ashtu edhe nga brenda, të cilat ndikojnë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe mundësojnë zhvillim ekonomik, ndërkohë që kryetari Jashari është zotuar se do të jetë në shërbim me të gjitha lehtësirat dhe përfitimet e çdo investitori.

Nënshkruhet marrëveshja për shërbime këshillore të ristrukturimit të Telekomit

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Me iniciativën e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Ljuka, është nënshkruar marrëveshja në mes të Bankës Evropiane për Ristrukturim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Telekomit të Kosovës.

Marrëveshja ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve konsultative përmes këshilltarëve të cilët do të zgjidhen me qëllim të dhënies së këshillave për ristrukturimin e Telekomit të Kosovës, e cila mund ta krijojë rrugën për privatizim.

Duke u gjetur në situatë të vështirë në aspektin operativ, Bordit i Drejtorëve në muajin maj të vitit të kaluar ka nxjerrë vendim për hapjen e fazës së ristrukturimit të kompanisë së bashku me implementimin e një plani për investime. "Në bashkëpunim me Bordin e Drejtorëve, si ministër përgjegjës për Ndërmarrjet Publike, kam kërkuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) që të ofrojë asistencë teknike (në formë të



grantit) për këshilltarë të cilët këshillojnë ministrinë rreth ristrukturimit dhe ripozicionimit të kësaj ndërmarrje. Në kërkesë kam potencuar faktin se Qeveria e Kosovës në bazë të planit të saj parasheh privatizimin e kësaj ndërmarrje. Gjithashtu, kam bërë të qartë se para gjithsecilit vendim të privatizimit, përmirësimit i performancës së ndërmarrjes si dhe praktikave brenda saj është prioritet dhe do t'i paraprijë çfarëdo procesi tjetër", është shprehur ministri Ljuka pas nënshkrimit të marrëveshjes në

mes të BERZH-it dhe Telekomit. Ai ka falënderuar BERZh-in që i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Qeverisë së Kosovës për pranimin e dhënies së asistencës në aspektin e prokurimit të ofrimit të këshilltarëve për të dhënë asistencë teknike në fazën e ristrukturimit si dhe ofrimin e këshilltarëve të jashtëm të cilët ofrojnë ekspertizën e tyre për hartimin e një udhërrëfyesi rreth privatizimit e cila do t'i vendosë hapat që duhet të ndjekë Qeveria e Kosovës në mënyrë që ta privatizojë Telekomit të Kosovës.

Fillon sanimi i dëmeve nga vërshimet në Malishevë

MALISHEVË, 23 QERSHOR (ER) - Shirat rënë ditët e fundit kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në Komunën e Malishevës për shkak të vërshimeve. Në disa fshatra vërshimet kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme duke bllokuar dhe dëmtuar rrugët në masë të madhe.

Komisioni komunal është duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe, pas kërkesës së komisionit për ndërhyrje urgjente në disa rrugë, ka filluar sanimi i dëmeve dhe hapja e rrugëve për qarkullim. Fshatrat më të goditura me dëme dhe bllokim të rrugëve janë Kërvasaria dhe Gurishta, për këtë shkak ka filluar largimi i

sasive të dheut dhe rërës, që kanë bllokuar rrugët.

Në vendngjarje, bashkë me ekipet përgjegjëse, ishte edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili i ka parë nga afër dëmet e shkaktuara. "Ekipet emergjente dhe ato të kontraktuara nga komuna kanë filluar pastrimin e rrugëve

në këto dy fshatra, pasi rrugët kanë qenë të bllokuara, ndërsa në ditët në vijim do të pastrohen edhe pjesët e tjera dhe do të vlerësohen dëmet, pasi komisioni komunal është duke bërë identifikimin e dëmeve në terren", ka thënë Berisha. Këtyre ditëve, sidomos javën e kaluar, janë dëmtuar rëndë



rrugët në Gurishtë (Goriq) dhe Kërvasari, ndërsa në fshatin Dragobil vetëtimta ka djegur kulmin e një ndërtese.

Në Sarajevë kanë vazhduar punimet e sesionit të gjashtë plenar të AP të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore

Khavit Haliti në Sarajevë thotë se Kosova është bërë eksportuese e sigurisë

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Khavit Haliti, në punimet e Sesionit të Gjashtë Plenar të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (AP E SEECP/PBEJL-së), në të cilin është folur për bashkëpunimin rajonal, ka theksuar se Republika e Kosovës është bërë eksportuese e sigurisë pasi, sipas tij, nëpërmjet FSK-së ka kontribuar në misionet e ndryshme të NATO-s



ekonomike dhe integritet në një treg më të gjerë evropian, me rëndësi të veçantë të zbatimit të plotë të rregullave dhe procedurave të CEFTA-s midis të gjithë pjesëmarrësve të kësaj marrëveshjeje.

Delegacioni i Kuvendit propozoi plotësimin e amendamentit të propozuar nga delegacioni serb: "Të gjitha palët duhet t'i respektojnë apo mbështesin plotësisht parimet e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe të pajtohen me marrëveshjet ekzistuese rajonale dhe dypalëshe. Për të ndodhur një gjë e tillë, pjesëmarrësit e SEECP-së zotohen që t'i njohin të gjitha autoritetet zyrtare respektive të vendeve të origjinës së produkteve".

Delegacionet e Kosovës dhe Serbisë nuk u pajtuan me propozimet reciproke, duke paraqitur argumente për dhe kundër.

Ky amendament tejkaloi agjendën e paraparë, duke hapur një debat të gjatë në mes të delegacionit të Kuvendit të Kosovës dhe delegacionit nga Parlamenti i Serbisë.

Sipas Rregullores së Punës së AP të SEECP-së, vendimet merren me konsensus. Përveç Kosovës, pjesëmarrës në këtë sesion janë edhe delegacionet nga Bullgaria, Turqia, Greqia, Rumania, Serbia, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia.

SEECP është një proces rajonal i themeluar në Sofje më 1996 me synimin për ta forcuar bashkëpunimin dhe besimin rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, stabilitetin dhe sigurinë, marrëdhëniet ekonomike dhe bashkëpunimin në dimensionin njerëzor, drejtësinë, luftën kundër krimit të organizuar dhe luftën kundër terrorizmit.

Asambleja Parlamentare e SEECP-së ka një rol të rëndësishëm, pasi që është një organizatë, ambicia e së cilës është të bëhet organizatë udhëheqëse parlamentare në rajon dhe që përfaqëson platformën më të përshtatshme për t'i përballuar sfidat e Evropës Juglindore.

Kosova merr pjesë në mënyrë të përhershme në aktivitetet dhe takimet e SEECP/PBEJL-së, në të gjitha nivelet dhe në kushte të barabarta. Gjatë Samitit të Brdos, mbajtur më 14 prill 2018, u vendos që Kosova ta marrë Presidencën dhe ta kryesojë SEECP-in në të gjitha nivelet.

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Delegacioni i Përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga nënkryetari Khavit Haliti, në përbërje të të cilit janë edhe Abdullah Hoti, Glauk Konjufca dhe Ismail Kurteshi, morën pjesë në punimet e Sesionit të Gjashtë Plenar të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (AP E SEECP/PBEJL-së), me temë "Lidhje më e mirë për një jetë më të mirë - si të arrihet një ndryshim i madh në procesin e bashkëpunimit rajonal", që po mbahet në Sarajevë të Bosnjë e Hercegovinës.

Në emër të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili njëherësh është edhe kryesues i delegacionit të Kuvendit në këtë Asamble, delegacionin e udhëhoqi nënkryetari Khavit Haliti. Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve në këtë sesion, nënkryetari Khavit Haliti ka theksuar domosdoshmërinë e vendosjes dhe thellimit të bashkëpunimit në mes të vendeve pjesëmarrëse të SEECP-së jo vetëm në nivel rajonal, por edhe në nivel bilateral. Duke vënë në pah

pengesat e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, si dhe masave të vendosura nga Bosnjë e Hercegovina për qytetarët e Kosovës, mesazhet e urrejtjes së ministrit serb Daçiq dhe komentet raciste të kryeministres Bërnabiq, si dhe rëndësinë e arritjes së marrëveshjes përfundimtare, gjithëpërfshirëse, për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për një stabilitet afatgjatë politik e ekonomik dhe parakusht që të dy shoqëritë të avancojnë drejt Bashkimit Evropian, nënkryetari Haliti ka rithek-suar rëndësinë e këtij procesi dhe zotimin e shtetit të Kosovës për dialog, arritjen e marrëveshjes dhe njohjen reciproke.

Sa i përket marrjes nga ana e Kosovës të kryesimit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore nga Bosnjë e Hercegovina, nga korriku 2019/2020 nënkryetari Haliti ka thënë se Kosova duhet ta shtojë bashkëpunimin rajonal dhe, sipas SEECP, është një platformë e shkëlqyeshme për ta përmirësuar gradualisht mënyrën e jetesës së qytetarëve tanë. "Ne duhet të përkrahim edhe nisma të reja, organizata joqeveritare, shoqërinë civile në përgjithësi dhe të gjithë aktorët e tjerë, që

të bashkëpunojnë më shumë me njëri-tjetrin. Por, fillimisht, neve na takon të udhëheqim këtë proces. Kosova është e gatshme ta marrë përgjegjësinë e vet dhe t'i marrë veprimet e duhura. Ne jemi krenarë që kemi arritur të jemi pjesë shumë me rëndësi e rajonit. Ne sot jemi jo vetëm konsumues të sigurisë, por edhe eksportues të saj, ku përmes FSK-së kemi kontribuar në misionet e ndryshme të NATO-s. Por, këto janë të ditura dhe nuk do të thellohem shumë", ka thënë Haliti.

Sesioni plenar u parapri nga

takimet e komisioneve të përgjithshme dhe komisionit të përhershëm qendror, të cilat u mbajtën në Parlamentin e Bosnjë e Hercegovinës.

Në takimet e komisioneve punuese u vendos që Kosova ta udhëheqë edhe komisionin e përgjithshëm për ekonomi, infrastrukturë dhe energji në periudhën 2019-2020, ndërsa Bullgaria do ta udhëheqë komisionin e përgjithshëm për zhvillim social, arsim, kërkime shkencore dhe shkencë. Gjatë seancës së sesionit plenar, Turqia ka vendosur që të kryesojë komisionin e përgjithshëm për drejtësi, punë të brendshme dhe bashkëpunim për sigurinë. Gjatë kryesimit të saj njëvjeçar (2019/2020) Kosova do ta udhëheqë edhe takimin e komisionit të përhershëm qendror dhe sesionin plenar (takimin e kryetarëve të parlamenteve të vendeve pjesëmarrëse të SEECP-s).

Sesioni Plenar i Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, i kryesuar nga Bosnjë e Hercegovina, nuk arriti ta miratojë dokumentin kryesor - deklaratën e përbashkët përfundimtare, sepse delegacionet e Kosovës dhe Serbisë nuk arritën konsensus për amendamentet që lidheshin me lirinë e lëvizjes së mallrave, shërbimeve dhe njerëzve brenda rajonit, si një forcë shtytëse e rritjes



Flet për "Epokën e re", Ilir Murtezaj

ATK-ja inkasoi 212.3 milionë euro

Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka bërë me dije se të hyrat e këtij institucioni për periudhën janar-maj të këtij viti janë 212.3 milionë euro që, në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, janë rreth 18.7 milionë euro më shumë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kanë zhvilluar rreth 127 aktivitete të konfiskimit të pasurisë që, si rrjedhojë, janë inkasuar mbi 2.6 milionë euro. Murtezaj ka thënë se nuk është i mjaftueshëm numri i inspektorëve që ka ATK-ja. Ai ka bërë me dije se kanë bërë kërkesë për rritjen e numrit të inspektorëve. Murtezaj ka treguar se me ardhjen e tij në krye të ATK-së janë zhvilluar një mori aktivitete në drejtim të reformave brenda këtij institucioni



sonale? Sa prej tyre paguajnë për pagën primare dhe sa për pagën sekondare?

Murtezaj: Në ATK numri i të punësuarve dhe i bizneseve që deklarojnë tatim në të ardhurat personale në vazhdimësi ndryshon. Mbi bazën e të dhënave të sotme kemi një numër prej 46 694 bizneseve që deklarojnë tatimin në të ardhurat personale dhe nga to për punëtor primar numri është 318 484 dhe sekondar 17 069, por dihet se këto deklaramë bëhen në një formular të përbashkët.

"Epoka e re": Moszbatimi i rekomandimeve të ZAP-it në disa raste, çfarë sfidash po sjellë?

Murtezaj: Bazuar në informatat që kam, si ATK kemi zbatuar pothuajse në tërësi rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm përjashtuar ato që nuk ndërlidhen me institucionet e tjera që edhe për ato raste ATK-ja ka zbatuar pjesën e detyrave të saj.

"Epoka e re": Jemi në prag të fillimit të sezonit veror. Si ATK, a do të jeni më rigoroz sa iu përket deklarimeve nga estrada e cila në këtë kohë ka më së shumti punë?

Murtezaj: ATK-ja, bazuar në planet vjetore dhe operative në pjesën sezonale, zhvillon aktivitete operacionale. Gjatë kësaj periudhe bëjmë përpjekje të jemi më afër atyre që kanë aktivitete të shtuar në këtë periudhë, pra duke mos përjashtuar as estradën që potencuat, por do të jemi aktivë edhe te pjesa e hotelarisë e cila ka shmangie nga tatimi, që për ne dhe për shtetin paraqet një potencial. Në këtë drejtim në baza ditore apo 24/7 zhvillojmë aktivitete me qëllim të identifikimit dhe sigurimit të informatave të mjaftueshme për të bërë vlerësime ndaj atyre që nuk përmbushin detyrimet ligjore. Te pjesa e estradës dhe në të kaluarën ka pasur raste në të cilat është rezultuar me detyrime shtesë. Sa për informatë, gjatë vitit të kaluar mbi gjysmë milionë euro janë paguar nga estrada.

"Epoka e re": Sa i përket pjesës së veriut, a keni shtrirje si ATK dhe a ka rezistim nga ana e tyre për t'i deklaruar tatimet?

Murtezaj: Shtrirje kemi, por ka edhe rezistim. Nuk mund të themi se si ATK mund të shkëputemi nga aktualiteti politik. Si rrjedhojë, as ATK-ja nuk mund ta evitojë këtë aktualitet. Aktualisht, ne kemi një numër të bizneseve që zhvillojnë aktivitete në atë pjesë dhe paguajnë tatim. Pra, janë rreth 1 100 biznese. Kemi një numër të komunitetit serb, janë 20 inspektorë të cilët janë të detyruar për çdo ditë të bëjnë inspektime në pjesën veriore. Ka edhe të komunitetit shqiptar të cilët bashkëpunojnë në inspektime.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 23 QERSHOR -

"Epoka e re": Z. Murtezaj, fillimisht na tregoni se çfarë e ka karakterizuar Administratën Tatimore të Kosovës që nga ardhja juaj në këtë detyrë?

Murtezaj: Siç dihet, ATK-ja të gjitha planet e veprimit i ka të bazuara në planet strategjike të qeverisë si dhe në Strategjinë e Luftimit të ekonomisë joformale. Ne si ATK në vazhdimësi zhvillojmë aktivitete të përmbyshjes vullnetare dhe bëjmë edhe veprime të tjera që janë prioritet i luftimit të ekonomisë informale, me fokus të tatimpaguesit që nuk i përmbushin detyrimet e tyre. Prej kur kam ardhur në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të ATK-së janë zhvilluar një mori aktivitete në drejtim të reformave brenda këtij institucioni. Fillimisht është ngritur llogaridhënia të pjesa e stafit operativ në drejtim të rritjes së kualitetit të punës dhe rritjes së zbatimit të ligjit. Po ashtu, ka pasur angazhim të pjesa e mbledhjes së borxheve ku zyrtarët tatimorë të ATK-së, si rezultat i këtyre veprimeve, kanë ndikuar edhe në pjesën e konfiskimit të pasurisë tek individët dhe bizneset që kanë detyrime të paslyera. Për periudhën tremujore kemi zhvilluar rreth 127 aktivitete të konfiskimit të pasurisë që, si rrjedhojë, janë inkasuar mbi 2.6 milionë euro. Kjo ka ndodhur për herë të parë në historinë e ATK-së, ku në një masë të madhe zhvillohen aktivitete të konfiskimit të pasurisë për personat dhe bizneset që nuk i kanë shlyer detyrimet e tyre. Kjo sigurisht se do të vazhdojë edhe më fuqishëm me qëllim të përmbyshjes së detyrimeve nga tatimpaguesit dhe borxhit që i kanë ATK-së. Përveç misionit dhe qëllimit të ATK-së, që është çështja e mbledhjes së borxheve, ana tjetër e medaljes është pjesa e krijimit të një tregu të barabartë për të gjithë tatimpaguesit brenda territorit të Kosovës. Aktivitet tjetër që vlen të

theksohet është edhe pjesa e ngritjes së një strukture të re brenda institucionit që drejtojmë. Së bashku me FMN-në kemi ndërtuar këtë strukturë që në tërësi është në funksion të realizimit të qëllimit dhe misionit të ATK-së. Përmes kësaj strukture do të jenë përgjegjësitë kyçe të secilit aktivitet brenda ATK-së.

Gjithashtu, aktivitet tjetër është edhe orientimi ynë për zbatim të reformave më të thella në histori të ATK-së, ku së bashku me FMN-në jemi duke shkuar në drejtim të automatizimit të procesit të punës brenda institucionit të ATK-së.

Fillimisht jemi në fazën finale të automatizimit të punës të rimbursimit, ku taksapaguesit që parashirojnë një kërkesë për rimbursim në vazhdimësi nga data e parashtrimit të kërkesës deri në përfundim të atij procesi kanë mundësi të jenë në informatë për të gjitha hapat se ku gjendet kërkesa e tij. Në këtë drejtim ligji për ATK-në parashihet që brenda 60 ditësh të kthehet përgjigja për rimbursim. Ne jemi duke tentuar që ta ulim këtë në 30 ditë, pra shqyrtimin e kërkesës për rimbursim dhe kthimin e mjeteve. Jemi në rrugë të mirë për ta automatizuar kategorizimin e kërkesës për rimbursim që bëhet duke ndikuar faktori njeri, duke e kategorizuar biznesin në kategoritë A, B, C sipas riskut që kanë këto biznese. Në një të ardhme të afërt ky proces do të bëhet përmes sistemit dhe nuk do të ketë ndikim faktori njeri. Kategoria A nënkupton bizneset që parashirojnë kërkesë për rimbursim dhe që nuk kanë risk për ATK-në. Në këto raste brenda periudhës shtatëditore do t'u rimbursohen mjetet. Në kategorinë B do të kemi një analizë më të thelluar dhe parashihet që brenda 20 ditësh të kthehen mjetet, ndërsa kategoria C ka të bëjë me bizneset që kanë parashtruar kërkesë për rimbursim që kanë risk në ATK dhe nevojitet të bëhet një kontroll më i hollësishëm.

"Epoka e re": Sa janë të hyrat e grumbulluara nga ATK-ja deri më tani dhe na tregoni burimin apo llojin e të hyrave?

Murtezaj: Të hyrat për periudhën janar-maj të këtij viti janë 212.3 milionë euro, që i bie se, në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi rreth 18.7 milionë euro më shumë apo 9.7 për qind më shumë. Sa i përket burimit të të hyrave, dihet që në ATK dominon pjesa e tatimeve direkte, që është rreth 43.3 për qind e të hyrave, pjesa tjetër nga tatimi në të ardhurat e korporatave dhe të ardhurat personale. Vlen të theksohet se nga praktikatat ndërkombëtare prioritet në administratat moderne duhet të jenë tatimet direkte që në këtë vit kemi një fokusim të rritjes së tatimeve direkte për dallim nga tatimet indirekte. Pra, kemi rritje më të lartë rreth 16 për qind në krahasim me vitin e kaluar.

"Epoka e re": Sa inspektorë ka ATK-ja në territorin e Kosovës dhe sa është i mjaftueshëm ky numër?

Murtezaj: Në si Administratë Tatimore e Kosovës kemi 812 të punësuar, prej tyre 311 janë inspektorë tatimorë, kurse 294 janë inspektorë të trenit dhe 17 janë inspektorë të ZGJONA-s, Zyrës për Gjykim dhe ndëshkime administrative. Sigurisht ky numër nuk është i mjaftueshëm. Kemi bërë kërkesa që të rritet ky

numër me synimin që të kemi një shtirje më të madhe të aktiviteteve në terren në mënyrë që të jemi sa më afër tatimpaguesve, sidomos ndaj atyre që krijojnë shmangie tatimore. Aktualisht këta që janë duke punuar, e ritheksoj, nuk janë të mjaftueshëm pasi kemi një numër rreth 70 000 të tatimpaguesve aktivë dhe është pothuajse e pamundur ta shtrijmë aktivitetin në të gjithë territorin. Orientimet tona janë të bazuar në analizën e riskut që identifikohet me risk më të lartë dhe që pastaj inspektorët tatimorë gjatë aktiviteteve të tyre duhet të jenë të orientuar te tatimpaguesit me risk potencial.

"Epoka e re": Sa iu përket transaksioneve mbi 500 euro përmes llogarive bankare, është diskutuar ulja e kësaj shume. Pra, çfarë është bërë në këtë drejtim?

Murtezaj: Në strategjinë e re kombëtare për luftim të ekonomisë informale që është miratuar këtë vit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka një ndryshim për këtë dhe pretendohet që të ulet në 150 euro. Momentalisht është 300 euro. Në ligjet tona ende nuk është vendosur kjo, pra në Ligjin për Administratën Tatimore që është në draft dhe duke kaluar në procedura.

"Epoka e re": Sa është numri i tatimpaguesve në të ardhurat per-

Bisedë me historinë dhe me dëshmorin e kombit Basri Canollin

(Halil Canolli, gjeneza e një gjenerali, libër kushtim, Tiranë, 2018)



Prof. dr. Emin KABASHI
Këshilltar shkencor
Instituti Albanologjik i
Prishtinës

Përkufizimi

Halil Canolli është babai i dëshmorit të kombit Basri Canolli. Po ashtu, Halil Canolli është edhe bashkëluftëtar i dëshmorit të kombit Basri Canolli. Më tutje, Halil Canolli është autor i një vepre, ta quajmë kushtimisht, libër kushtim, në të cilën bisedohet në të njëjtën kohë, edhe me historinë, edhe me të birin, dëshmorin e kombit, Basri Canolli. Në vija të trasha ky është letërnjoftimi i autorit të këtij libri kushtim, në të cilin duke e kujtuar Luftën e Ushtrisë 'Çlirimtare të Kosovës, duke e kujtuar luftën e të birit dhe luftën e tij, nuk ka periudha historike, me të cilën nuk ka biseduar Halil Canolli. Por, e veçanta e këtij libri është se ai nuk ka biseduar me periudha të ndryshme historike, që të na mësojë ne të tjerëve, ngjarje, apo rrethana, apo periudha kohore, që nuk janë ditur. Ai ka biseduar me to, njësoj sikur të ishte gjallë dëshmorin e kombit, Basri Canolli, në mënyrë që të ia kujtonte atij se lufta e tij dhe e bashkëluftëtarëve të tij, pra lufta e popullit shqiptar, ishte luftë e drejtë dhe ishte luftë çlirimtare.

Hyrije

Cila është biseda që bën Halil Canolli me historinë? Kujt ia rrëfen ato ngjarje historike Halil Canolli? Atëherë, cili është dhe çka është ky libër? Këto do të mund të ishin hipotezat e mundshme, që na japin dorë të flasim për librin e Halil Canollit, gjeneza e një gjenerali, që siç dihet, i është kushtuar dëshmorit të kombit, Basri Canolli. Në të parë, mund të thuhet se bisedojnë babë e bir. Por ky është vetëm mashtrimi i parë që na afron rrëfimi bisedimor i Halil Canollit me historinë. Më tutje, mund të thuhet se autori ka dashur të çmallet me djalin, që ka rënë në fushën e nderit, për lirinë e kësaj pjese të atdheut. Mirëpo, autori i librit, Halil Canolli ka qenë edhe vet ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, andaj ishte pjesë e obligimit, si edhe i biri, dëshmorin e kombit, Basri Canolli, se liria e atdheut është mbi të gjitha.

Do të thotë, autori i librit, Halil Canolli, ka biseduar me historinë tonë, që nga lashtësia e deri të Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, jo vetëm sa për të thënë se bisedova me historinë, jo vetëm që të çmallet me të birin dëshmor, por që të na flasë edhe ne të tjerëve, bashkëkombësve të tij, të djeshëm dhe të sotëm, se nëpër cilat udhë të historisë ka ecur jeta historike e popullit shqiptar, në mënyrë që ta qartësojë, jo vetëm luftën e dëshmorit të kombit, Basri Canolli, por edhe rënien e tij, në altarin e lirisë së atdheut, ose thënë më saktë, në luftën për lirinë e pjesës së atdheut të pushtuar dhe të robëruar.

Historia dhe rënia e dëshmorëve të kombit

Në këtë libër-kushtim, siç u përkufizua në fillim të këtij shkrimi, autori herë pas here, nuk është i kënaqur me rrjedhën e ngjarjeve, sidomos pas Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, ne lexuesit, do të mund t'i thoshim, epo kush është i kënaqur. Rrjedhimisht, kjo mënyrë e bisedës me historinë, i ka dhënë dorë autorit që të bisedojë edhe me dëshmorin e kombit Basri Canollin, pra me djalin e tij, në njërin anë, si dhe me të gjithë të rënë të lirinë e atdheut në anën tjetër. Nëse qëndron ky përkufizim, gjë që besoj se qëndron, atëherë mund të thuhet se autori i këtij libri, Halil Canolli, ka biseduar me historinë dhe me dëshmorët e kombit, të të gjitha kohëve, duke shpaluar herë pas here, çalimet që kanë ndodhur pas rënies së dëshmorëve, duke prekur të dhëna që janë bërë pjesë e kujtesës sonë historike, duke u marrë me praninë e duarve të qendrave të vendosjes evropiane, jo vetëm me rrugët e ecjes historike të popullit shqiptar, por të shumtën e herëve, edhe me hisen e tyre në tragjedinë tonë kombëtare. Mbi të gjitha, duke biseduar me historinë, duke u marrë me padrejtësitë e saj ndaj popullit tonë, autori në një mënyrë, ose në një tjetër, ka bashkëbiseduar edhe me të gjithë dëshmorët e kombit, jo vetëm të kësaj luftës që shqiptarët ishin të detyruar ta bënin në fund të shekullit njëzet dhe në fillim të shekullit njëzet e një, por me të gjithë ata që kishin dhënë jetën dhe kishin luftuar për lirinë, që nga heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu e deri te dëshmorin e kombit Basri Canolli. Kjo mënyrë e bisedimit me historinë, andaj edhe me dëshmorin e kombit Basri Canollin, i ka dhënë dorë autorit të librit gjeneza e një gjenerali, t'ia kujtojë të birit, pra dëshmorit të kombit Basri Canolli, andaj edhe gjener-

atës së tij, andaj edhe të gjitha gjeneratave të shqiptarëve, se në jetën tonë historike, asgjë nuk ka ndodhur rastësisht, asgjë nuk ka ardhur nga qielli, as nuk ka mbirë vetiu nga toka, por çdo ngjarje historike, që ka kërkuar edhe hisen e gjakut tonë, ka pasur për taban së pari historinë familjare, pastaj historinë e rrethit, pastaj historinë e atdheut. Nëse mund të përthekohet në këtë mënyrë rrëfimi i ngjarjeve në këtë libër, atëherë qartësohet hipoteza se cili është dhe çka është ky libër. Një libër, ku një luftëtarë i lirisë, bashkë me të birin, që është dëshmorin e kombit, u kthehet ngjarjeve historike, periudhave të ndryshme të atyre ngjarjeve, jo vetëm për të hequr harrimin nga ato, por që ta dëshmojë se ato janë pjesë e jetës sonë, janë pjesë e edukatës sonë dhe në fund të fundit, janë pjesë e dashurisë sonë ndaj lirisë së atdheut. Nuk ka pakënaqësi, e vogël apo e madhe, që e përmbys këtë qëndrim të autorit, që shpalohet nga fillimi e deri në fund të këtij bashkëbisedimi me historinë.

Sa herë historia e ka zvogëluar atdheun, ka zvogëluar edhe jetët tona

Autori i librit gjeneza e një gjenerali, Halil Canolli, bashkëluftëtar i të birit dëshmorin e kombit, Basri Canolli, duke biseduar me historinë, me të kaluarën dhe me të tashmen, me ngjarje tragjike, por edhe me idealin e luftëtarit të lirisë, nuk është dorëzuar para asnjë të keqeje të madhe që historia ia kishte kurdisur popullit shqiptar. Në këtë libër del një porosi e madhe, që herë thuhet hapur, herë kuptohet nënteksti i saj, se sa herë historia me padrejtësitë e saj ka zvogëluar atdheun tonë, ka zvogëluar edhe jetët tona. Kështu i kishte ndodhur Shyt Marecit të së kaluarës së afër, kështu i kishte ndodhur Mulla Idriz Gjilanit, që e kishte thënë atë fjalën proverbiale në Kuvendin e Prizrenit, më 1945: "Me Serbinë jo, me Shqipërinë po"! Kështu u kishte ndodhur edhe bashkëluftëtarëve të tij, disa prej të cilëve janë me emër e mbiemër, pra kështu i kishte ndodhur edhe Shpendit të tij, siç e quanin bashkëluftëtarët, dëshmorin e kombit dhe heroin e Kosovës, Basri Canollin, sepse duke u munguar arma e duhur, duke u munguar municioni, duke u munguar shërimi i plagëve, atyre u kishte mbetur vetëm ideali i gatishmërisë së tyre që të flijohen për lirinë e kësaj pjese të atdheut në mënyrë që të hapet rruga historike e bashkimit kombëtar. Një pjesë e librit, gjeneza e një



gjenerali, thajse është ditari personal i autorit. Një ditari me shumë shënime e të dhëna interesante, jo vetëm për ngjarjet e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, jo vetëm për Gallakun dhe Marevcin e tij, jo vetëm për bashkëluftëtarët e tij, as vetëm për tre djemtë e tij, luftëtarë të lirisë, por edhe për politikën e madhe të Evropës dhe të Amerikës, për dilemat dhe hamendësimet e tyre, për mosnjohjen e realitetit shqiptar dhe për mungesën që të pranojnë, qoftë si vrasje e ndërjegjes, padrejtësitë historike që ia kishin shkaktuar popullit shqiptar. Në ditarin e tij, ka citime e deklarata të agjencive të ndryshme informative, të delegacioneve të ndryshme që vinin dhe shkonin nga Kosova, pa bërë asnjë zgjidhje, ka mendime të shkëputura të burrështetasve të vendeve të ndryshme, thënë nëpër gazeta nga më të ndryshme, sa ndonjëherë lexuesi habitet, si është e mundur të ketë thithur tërë këtë informacion, ditari e javor, mujor e vjetor, një luftëtar i fronteve të luftës për liri, siç ishte ushtria e tij Çlirimtare e Kosovës, siç ishte Malësia e Gallakut, siç ishte Marevcin i tij. Në ditarin e tij, që autori e ka përfshirë në këtë libër, ka aq shumë të dhëna për zhvillimin e ngjarjeve rreth Kosovës dhe për Kosovën, sa ndonjëherë lexuesi hutohet se kush çka ka thënë në akëcilën gazetë, apo në akëcilin tubim. Më tutje, në ditarin e tij, që është pjesë e librit gjeneza e një gjenerali, autori Halil Canolli ka sjellë të dhëna përshkruese për ditët e fundit të luftimeve në Marevcin e tij, sidomos për ushtarët e lirisë të Brigadës 153, të cilën e komandonte, eprori emblemantik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Shehu. Qoftë vetëm përshkrimi i luftimeve në ato ditë, nga data e 7 deri në përfundim të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, jo vetëm i jep kuptim tërësisë së librit të autorit Halil Canolli, por sjellë para lexuesit të sotëm, edhe atmosferën e atyre ngjarjeve, sjellë emrat e njerëzve që kanë rënë në frontet e luftës për liri, sjellë dilemat dhe pedatjet e luftëtarëve kur janë përballur me armikun, kur u kanë rënë shokët

në vijat e fronteve, kur kanë bartur të plagosurit, duke harruar të shumtën e herëve, edhe lodhjen, edhe urinën, edhe mungesën e municionit, por edhe të armëve për ata që mbushnin për çdo ditë radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Përfundim

Autori i librit gjeneza e një gjenerali, Halil Canolli, nuk ka harruar që duke biseduar me historinë, por edhe me të birin Shpendin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dëshmorin e kombit dhe heroin e Kosovës, Basri Canollin, të thotë edhe mendimin e tij, pa u lodhur aspak se i pëlqen dikujt a nuk i bie tamam, për të djeshmen dhe të sotmen e jetës sonë, për lëshimet e djeshme dhe për keqpërdorimet e sotme, andaj ky bashkëbisedim me historinë dhe të birin, luftëtarin e lirisë, është edhe një rrëfim me ngarkesë emocionale, sidomos kur bëhet fjalë për padrejtësitë historike ndaj popullit shqiptar, por edhe për keqpërdorimet politike që po ashtu përplasen në kurrizin e popullit shqiptar. Autori Halil Canolli, libri i të cilit, gjeneza e një gjenerali është përfunduar më 17. 6. 2019, në 20-vjetorin e rënies së dëshmorit të kombit, Basri Canolli, ka lënë dëshmi të shumta, qoftë për të kaluarën historike, ku si në ditën me diell shihen padrejtësitë që i janë bërë atdheut të tij, qoftë për idealin e luftëtarëve të lirisë, që ishin të gatshëm të flijonin edhe jetën për lirinë dhe bashkimin kombëtar, qoftë edhe për skenat dhe prapaskenat e qendrave të ndryshme të Evropës, edhe në kohën kur Lufta e Ushtrisë Çlirimtare kishte bindur katërçipërisht tërë opinionin shqiptar dhe të huaj, se ishte bërë dalëzotësja e popullit shqiptar, andaj edhe ardhja e lirisë dhe e çlirimit të kësaj pjese të atdheut tonë, Shqipërisë, po vinte me grykën e pushkëve të saj, që është e vetmja liri reale dhe historikisht e qëndrueshme. Pjesë e kësaj qëndrueshmërie historike të lirisë së atdheut është edhe rënia e dëshmorit të kombit dhe heroit të Kosovës, Basri Canolli, që i kushtohet ky libër në 20-vjetorin e rënies së tij.

Prishtinë, më 17. 6. 2019

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Majlinda e historisë

Majlinda Kelmendi dhe sporti i xhudos, i udhëhequr nga trajneri Driton Kuka, vazhdojnë të shkruajnë historinë e re për sportin e Kosovës. Pas shumë medaljeve të fituara në turne dhe kampionate të ndryshme dhe në Lojërat Olimpikë në Brazil, Majlinda të shtunën e fitoi edhe medaljen e parë të artë në Lojërat Evropiane



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Xhudistja Majlinda Kelmendi e fitoi medaljen e parë olimpikë për Kosovën, në kategorinë 52 kg në xhudo për femra, në Lojërat Olimpikë që u mbajtën në Rio De Janiero të Brazilit, por krenaria e sportit dhe shtetit të Kosovës nuk u ndal, pasi fitoi edhe shumë medalje të tjera në turne e kampionate të ndryshme, derisa medaljen e fundit të artë e fitoi në Lojërat Evropiane "Minsk 2019". Në këtë mënyrë Majlinda e shkroi edhe një herë tjetër historinë për sportin e Kosovës duke fituar për herë të parë një medalje të artë në Lojëra Evropiane.

Kelmendi në finale e mposhti me Ippon kampionen e deritashme të Evropës, rusen Natalia Kuziutina. Kosova kishte marrë pjesë edhe në vitin 2015 në Lojërat Evropiane "Baku 2015", por atëkohë Majlinda kishte munguar dhe Nora Gjakova ia kishte arritur ta fitonte medaljen

e bronzitë. Nora edhe sivjet fitoi medalje, por kësaj radhe të argjendtën.

Pas triumfit në Bjellorusi, Majlinda Kelmendi ka treguar se vazhdon të jetë gjithmonë e uritur për fitore të reja. "Kurrë nuk jam e kënaqur. Dua gjithmonë të fitoj dhe të jam në krye. Kjo është arsyeja pse punoj kaq fort", ka thënë Kelmendi. "Sigurisht se po ndihem shumë e lumtur. Është hera e parë që po marrë pjesë në lojëra evropiane. Kjo në sportin tonë është edhe kampionat evropian, edhe lojëra evropiane, për këtë arsye i morëm nga dy medalje. Ka qenë një ditë e gjatë, e vështirë dhe mund të them se sot kam qenë mjaft e motivuar dhe besoj që gara ka shkuar shumë mirë", ka deklaruar Majlinda Kelmendi.

Akil Gjakova ndalet në rrethin e tretë

Xhudisti Akil Gjakova nuk ka mundur ta vazhdojë rrugën drejt medaljes sikurse Majlinda

Kelmendi dhe Nora Gjakova. Akili u ndal në rrethin e tretë të garave në Lojërat Evropiane "Minsk 2019" nga greku Georgios Azoidis, kategoria -73 kg. Një gabim i Akilit i kushtoi me humbje.

KOK-u falënderon presidentin Thaçi

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, mori pjesë në ceremoninë hapëse të Lojërave Evropiane "Minsk 2019", të cilat po mbahen në kryeqytetin e Bjellorusisë. Presidenti Thaçi ishte në përkrahje të sportistëve të Kosovës, të cilët po e përfaqësojnë denjësisht vendin e tyre. Presidenti Thaçi pati një takim me drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, kryetarin Besim Hasani dhe sekretarin e përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj. KOK-u e falënderoi presidentin Thaçi për gatishmërinë dhe përkrahjen e vazhdueshme që po ia jep ekipit olimpik të Kosovës.

SHKURT

Drejtuesit e FBK-së bëjnë homazhe te varri i Gazmend Sinanit

Sot u bë një vit nga vdekja e basketbollistit të njohur Gazmend Sinani. Ai ishte pjesë e Përfaqësueses së Kosovës, një basketbollist dhe person i jashtëzakonshëm. Drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës, në krye me sekretaren e Përgjithshme, Elvira Dushku dhe drejtorin e Përfaqësuesve, Granit Rugova, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule te varri i Sinanit. Ata kanë kujtuar Gazin si një lojtar, si një njeri i mirë dhe i dashur për të gjithë. Sinani nuk do të harrohet asnjëherë nga adhuruesit e basketbollit. Në nderim të tij, numri 15 është pensionuar nga Federata e Basketbollit të Kosovës.

Muriqi transferohet në Galatasaray

Sulmuesi i përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, do t'i bashkohet gjigantit turk Galatasaray. Mediet në Turqi raportojnë se skuadra e Çaykur Rizesporit është pajtuar për ta shitur sulmuesin nga Kosova për një shumë prej katër milionë eurosh.

Drita prezanton Izair Eminin

Izair Emini edhe zyrtarisht është futbollist i Dritës. 33-vjeçari është prezantuar nëpërmjet një video nga skuadra e Dritës. Futbollisti shkëputi kontratën me skuadrën e Shkëndijës nga Tetova dhe vendosi ta pranojë ofertën e Dritës para disa ofertave të tjera. Emini ka luajtur edhe për Renovën dhe Kukësin.

Ademi dhe Salihu takohen me ish-futbollistin Xhevdet Muriqi

Drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës, kryetari Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, e kanë takuar ish-futbollistin e gjeneratës së artë të Prishtinës, Xhevdet Muriqin. FFK-ja ka njoftuar se gjatë këtij takimi, përveç kujtimeve të përbashkëta për futbollin e viteve të '80-ta, ata diskutuan edhe për futbollin e tanishëm si dhe për sukseset që po i arrin përfaqësuesja e Kosovës. Ish-futbollisti i Prishtinës përgëzoi drejtuesit e FFK-së për punën e bërë, duke uruar vazhdimin e serisë pozitive për "Dardanët" në ndeshjet e ciklit kualifikues për "Euro 2020".

Drenica rikthen Hamitin

Mesfushori sulmues Genc Hamiti është përforcimi i radhës i skuadrës nga Skenderaj, Drenicës, i cili është produkt i shkollës së futbollit kuqezi, ka arritur marrëveshje njëvjeçare me klubin. 25-vjeçari do të prezantohet sot (e hënë). Klubi nga Skenderaj po vazhdon me ritëm të lartë punën për kompletimin e skuadrës dhe në ditët në vijim priten përforcimet e tjera.

Të martën dalin në shitje biletat për ndeshjet e Ligës së Kampionëve

Ndeshjet e turneut preliminar të Ligës së Kampionëve do të zhvillohen në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Ndeshja e parë, mes Tre Penne dhe FC Santa Coloma, zhvillohet nga ora 15:00, kurse takimi mes KF Feronikelit dhe Lincoln Red Imps do të fillojë prej orës 20:45. Të dyja takimet zhvillohen të martën më 25 qershor. Biletat do të dalin në shitje të martën nga ora 08:00, në pikën në Drenas: "Restaurant Dijamant" dhe në pikën në Komoran, "Pizzeria Dijamant". Në orë të njëjtë fillon edhe shitja në Prishtinë, në stadiumin e kryeqytetit "Fadil Vokrri". Çmimet e biletave për ndeshjen Feronikeli - Lincoln Red Imps do të jenë këto: 5 euro për Zonën e Lindjes dhe Zonën e Perëndimit, kurse 10 euro bileta për Zonën VIP. Ndërsa për takimin mes Tre Penne dhe FC Santa Coloma çmimi do të jetë 3 euro për Zonën VIP.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË

Drejtoria për Arsim dhe Edukim
Nr: 11/494
Datë: 21.06.2019

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës. Sqarim: Drejtimet për shkolla shpallen sipas Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, (KKK). Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpallë:

**KONKURS
PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË
SHKOLLAVE PROFESIONALE PËRVITIN SHKOLLOR 2019-2020.**

Malishevë, Qershor 2019

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazëve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2019/20, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftësive në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
1. Letërpërfaqjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
2. Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2019/2020, bëhet më datën: 24, 25 dhe 26 qershor 2019 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 28.06.2019. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 29.06.2019. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:
1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë
Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.
Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet me mesataren e notave të kl. 6-9 të (5+5+5+5) = 20; 20 : 4 = 5)
 $\frac{mesatarja\ e\ lëndës\ (I) + mesatarja\ e\ lëndës\ (II) + mesatarja\ e\ lëndës\ (III)}{3} \times 3 = 15\ pikë$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë në këtë rast vlera e fituar pjesëtohet me 2 dhe shumëzohet me 3

$$\frac{mesatarja\ e\ lëndës\ (I) + mesatarja\ e\ lëndës\ (II)}{2} \times 3 = 15\ pikë$$

Në rast se kemi 5 lëndë prapë mblidhen mesataret e 5 lëndëve pjesëtohen me 5 dhe shumëzohen me 3.

3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

Gjimnazi i shkencave natyrore - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lënda fizikë, kimi dhe biologji)
p.sh për tri lëndë: $\frac{Kimi\ (3) + Biologji\ (4) + Fizikë\ (5)}{3} = \frac{3 + 4 + 5}{3} = \frac{12}{3} = 4$

Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)

Për 5 lëndë:
mes. Gj. amtare + mes. gj. angleze + mes. his + mes. gjeo. + mes. ed. qytet
 $\frac{\quad}{5} \times 3 = 15\ pikë\ max$

B. Përmbajtja e testit-numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë

- Gjuhë shqipe 20 pikë
- Gjuhë angleze 5 pikë (gjithsej 25 pikë)

II. Shkencat shoqërore

- Gjeografi -----12 pikë
 - Histori -----13 pikë
- (Gjithsej 25 pikë)

III. Shkencat natyrore:

- Fizikë -----9 pikë
- Kimi ----- 8 pikë
- Biologji ----- 8 pikë (Gjithsej 25 pikë)

3. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

- Shkencat e natyrës 25 25 x 1.2 = 30 pikë
 - Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 0.6 = 15 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.4 = 10 pikë
 - Shkencat shoqërore 25 25 x 0.2 = 5 pikë
- Totali = 60 pikë**

II. Gjimnazi shoqëror dhe gjuhësor:

- Gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe shkenca shoqërore 50 50 x 0.9 = 45 pikë
 - Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 0.4 = 10 pikë
 - Shkenca natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë
- Totali = 60 pikë**

4. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në shkolla profesionale

I. Agrobiznes

- Shkencat e natyrës 25 25 x 1.2 = 30 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.6 = 15 pikë
 - Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 0.4 = 10 pikë
 - Shkencat shoqërore 25 25 x 0.2 = 5 pikë
- Totali = 60 pikë**

II. Elektroinstalues

- Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 1.2 = 30 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.6 = 15 pikë
 - Shkencat e natyrës 25 25 x 0.4 = 10 pikë
 - Shkencat shoqërore 25 25 x 0.2 = 5 pikë
- Totali = 60 pikë**

III. Ekonomi

- Matematikë dhe informatikë 25 25 x 1.2 = 30 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.6 = 15 pikë
 - Shkenca shoqërore 25 25 x 0.4 = 10 pikë
 - Shkencat natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë
- Totali = 60 pikë**

IV. Juridik

- Shkencat shoqërore 25 25 x 1.2 = 30 pikë
 - Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.6 = 15 pikë
 - Matematikë dhe informatikë - 25 25 x 0.4 = 10 pikë
 - Shkenca natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë
- Totali = 60 pikë**

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 1.2 = 30 pikë
 - Shkenca shoqërore 25 25 x 0.6 = 15 pikë
 - Matematikë dhe informatikë - 25 25 x 0.4 = 10 pikë
 - Shkenca natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë
- Totali = 60 pikë**

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë-duhet të nënshirohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

MALISHEVË

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr. i paral.	Nr. i nxën.	Vit. e shkoll.	
Kievë	SH.M.P	Ekonomi	Kontabilitet	1	32	2+1	
			Administrim biznesi	1	32	2+1	
			Banka dhe sigurime	1	32	2+1	
			Asistent juridik	1	32	2+1	
			Asistent i administratës	1	32	2+1	
			Gjithsej-"L. Poradeci"	5	160		
Malishevë	Qendra e Kompetencës	Ekonomi	Administratë, shërbime në zyrës	3	96	2+1	
			Banka dhe shërbime të sigurimeve	1	32	2+1	
			Shitje & Marketing	2	64	2+1	
			Agrobiznes	1	32	2+1	
			Hoteleri & Turizëm	1	32	2+1	
			Logjistikë & operim në magazinë	2	64	2+1	
			Elektroteknike	Elektroinstalues	1	32	2+1
				Shërbime të TIK-ut	1	32	2+1
				Gjithsej-"Qendra e kom."	12	384	
						GJITHSEJ-Malishevë	17

Nr	Shkolla	Drejtimet	Nr. i paral.	Nr. i nxën.	Gjithsej
1	Gjimnazi "Hamdi Berisha" Malishevë	Shkencat natyrore	7	32	224
		Shkencat shoqërore	7	32	224
		Shkencat natyrore	1	32	32
2	Gjimnazi "Hamdi Berisha" paralelja në Kjeve	Shkencat shoqërore	1	32	32
		Gjithsej -Malishevë	16		512 nx,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 197/1
Datë: 24.06.2019

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë(10) në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2019/2020 Prishtinë, qershor 2019

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2019/20, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftësve në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për shkolla profesionale për vitin shkollor 2019/2020, bëhet më datën 24, 25 dhe 26 qershor 2019 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 28.06.2018. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 29.06.2018. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa. Për të gjitha Qendrat e Kompetencës vlen kriteri 24 nxënës për klasë.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet me mesataren e notave të kl. 6 - 9 të (5+5+5+5) = 20; 20 : 4 = 5)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë atëherë: 2 X 5 = 10 në këtë rast vlera e fituar shumëzohet me 1.5.

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

1. Rendi i lëndëve me prioritete sipas profileve në shkolla profesionale
 1. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

1. Shëndetësi 25 25 x 1.2 = 30 pikë
2. Shkencat natyrore 25 25 x 1.2 = 30 pikë
3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.6 = 15 pikë

4. Matematikë dhe informatikë 25 25 x 0.4 = 10 pikë
5. Shkencat shoqërore 25 25 x 0.2 = 5 pikë

Totali = 60 pikë

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi - Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 1.2 = 30 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.6 = 15 pikë
3. Shkenca natyrore 25 25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkenca shoqërore 25 25 x 0.2 = 5 pikë

Totali = 60 pikë

III. Ekonomi

1. Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 1.2 = 30 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.6 = 15 pikë
3. Shkenca shoqërore 25 25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkencat natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë

Totali = 60 pikë

IV. Juridik

1. Shkencat shoqërore 25 25 x 1.2 = 30 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 0.6 = 15 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkenca natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë

Totali = 60 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 1.2 = 30 pikë
2. Shkenca shoqërore 25 25 x 0.6 = 15 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkenca natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë

Totali = 60 pikë

VI. Shkollat Artistike

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 25 x 1.2 = 30 pikë
2. Shkenca shoqërore 25 25 x 0.6 = 15 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25 25 x 0.4 = 10 pikë
4. Shkenca natyrore 25 25 x 0.2 = 5 pikë

Totali = 60 pikë

KONKURSI PER QENDRAT E KOMPETENCES 2019/20

Mësimi në gjuhën shqipe								
Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr./Nxënësve	Vitet		
Prizren	"11 Marsi"	Elektroteknikë	Dizajn Softwerik	1	24	2+1		
			Informatikë	2	48	2+1		
			TIT (Tek. e Informacionit dhe Telekomunikacionit)	2	48	2+1		
			Instalues elektrik	1	24	2+1		
			Makina elektrike	1	24	2+1		
			Mekatronikë (Robotik)	1	24	2+1		
		Komunikacion	Trafik rrugor	2	48	2+1		
			Automekanikë	2	48	2+1		
			Instalues i Ujësjesit	1	24	2+1		
		Makineri	Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit	3	72	2+1		
			Metalpunues/Dizajn i metaleve	1	24	2+1		
			Gjeodezi	Ndërtimtar	1	24	2+1	
		Ndërtimtari	Arkitekturë	1	24	2+1		
			Gjeodezi	1	24	2+1		
		Arte te aplikuar	Dizajn grafik	1	24	2+1		
			Dizajn enterieri	1	24	2+1		
			Dizajn i veshjeve - tekstili	2	24	2+1		
			Gjithsej- Sh. "11Marsi" Gj. shqipe	24	576			
		Mësimi në gjuhën boshnjake						
		Elektroteknikë	Dizajn Softwerik	1	24	2+1		
Dizajn enterieri	1		24	2+1				
Arte të aplikuar	Dizajn i veshjeve & tekstili	1	24	2+1				
	Gjithsej- Gj. Boshnake	3	72	2+1				
Mësimi në gjuhën turke								
Makineri	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	1	24	2+1				
	Gjithsej- Gj.Turke	1	24	2+1				


Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nxënësve	Vitet		
Prishtinë	Shmlp "Shtjefën Gjeçovi"	Makineri	Dirigjim kompjuterik i makinave	1	24	2+1		
			Metalpunues	1	24	2+1		
			Automekanik	2	48	2+1		
			Instal. i ngroh. Kimatizi.	2	48	2+1		
			Instalues i ujit dhe kanalizi.	1	24	2+1		
			Trafik rrugorë	1	24	2+1		
		Transport dhe Trafik	Transport rrugor	1	24	2+1		
			Lëvizje e trenave	1	24	2+1		
			Tekstil	Konfeksioner	2	48	2+1	
		Rrobaqepesi		1	24	2+1		
		Gjithsej - "Sh. Gjeçovi"				13	312	

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nxënësve	Vitet
Skenderaj	Qendra e Kompetencës	Ndërtimtari e Lartë	Murator dhe plakështrues	3	90	2+1
			Belon punues			
			Ngjyrë punues, Llak punues			
			Llamarinë punues dhe punues metali			
			Konstruksione të thata			
			Zdrukthëtar me punë kulmi			
			Energji, klimatizim dhe mjedis			
		Instalues i ujit, sanitarive dhe sistemeve të energjisë				
		Instalues elektrik				
		Art	Dizajn i tekstilit & veshjeve	1	30	2+1
Arkitekturë	Arkitekturë	1	30	2+1		
Gjithsej - QK - Skenderaj				7	210	


Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nxënësve	Vitet
Prizren	Qendra e Kompetencës	Ekonomi	Nepunes industrie	1	24	2+1
			Nepunes finance	1	24	2+1
		Tregti	Sherbimet ndaj konsumatorit dhe shitjes	1	24	2+1
			Nepunes i eksport-import	1	24	2+1
		Turizem	Udheqes i udhetimeve dhe grupeve turistike	1	24	2+1
			Asistent ne zyra informimi dhe agjenci turistike	1	24	2+1
			Asistent në organizimin e ngjarjeve (Evenimenteve)	1	24	2+1
Gjithsej - QK - Prizren				7	168	

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nxënësve	Vitet		
Malishevë	Qendra e Kompetencës	Administratë	Administratë dhe shërbime të zyrës	3	96	2+1		
			Elektroinstalues	1	32	2+1		
			Agrobiznes	1	32	2+1		
		Ekonomi	Banka dhe shërbime të sigurimeve	1	32	2+1		
			Shitje dhe marketing	2	64			
			Shërbime të TIK-ut	1	32	2+1		
			Logjistikë dhe operim në magazinë	2	64	2+1		
			Hoteleri dhe turizëm	1	32	2+1		
			Gjithsej - QK - Malishevë				12	384

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	paralet	Nr.Nxënësve	Vitet
Ferizaj	Qendra e Kompetencës	Shëndetësi	As kujdesi Social & Shëndetësor	1	24	2+1
			As. i Fizioterapisë	1	24	2+1
			Teknik Dentar	1	24	2+1
			Teknik i Farmacisë	1	24	2+1
			Teknik i Optikës	1	24	2+1
			As. Siguria Ushqimore & Dietat	1	24	2+1
			Gjithsej - QK - Ferizaj			



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
 Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Deklaro saktë tatimin!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat, të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar të deklarojnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te kategoritë, si: Nën-deklaruesit e pagave të punëtorëve, nën-deklaruesit tek bizneset e mesme dhe të mëdha, nën-deklaruesit tek bizneset mikro dhe të vogla, me qëllim të identifikimit të atyre bizneseve, të cilat nën deklarojnë të ardhurat e tyre.

Disa nga veprimtaritë në vijim, nuk zbatohen këtë obligim, prandaj ATK, u bënë thirrje që të deklarojnë apo korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përmbushin të gjitha obligimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor:

- Identifikimi i bizneseve, të cilat nën-deklarojnë pagat e punëtorëve;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim, në veçanti veprimtaritë, si: tregti, shërbime, ndërtimtari dhe prodhim;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht në kuotën fikse prej 37.5€ në çdo 3 muaj;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht nën pragun e TVSH-së, veçanërisht bizneset në veprimtari, si: tregti, shërbime profesionale, zbavitëse-artistike, prodhim, transport, etj;
- Identifikimi i bizneseve, të cilat operojnë me humbje, si dhe bizneseve që deklarojnë me zero;
- Identifikimi i bizneseve të cilat ofrojnë furnizime pa të drejtën e kreditimit të TVSH-së, ndërsa në anën tjetër zbresin TVSH-në në blerje;
- Identifikimi i bizneseve të cilat importojnë apo tregtojnë mallra me akcizë, të cilët përmes dokumentacionit jo të saktë, respektivisht nënvlerësimi të çmimeve të shitjes, i'u shmangen detyrimeve tatimore;
- Identifikimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e tekstilit dhe veshmbathjeve, të cilat mbajnë dokumentacione jo të sakta me qëllim të shmangies së detyrimeve tatimore, etj;
- Identifikimi dhe trajtimi i personave, të cilët nuk bëjnë deklarimin e të ardhurave të ndryshme që ata mund të kenë qoftë të hyrat nga jasthë vendit, të hyrat nga kapitali apo të hyrat tjera.

ATK, inkurajon të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK, do të detyrohet që të ndër marrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare, siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimit me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

ATK, në bashkëpunim me FMN, në implementim të Projektit "Përmbushja në Sektorin e Ndërtimtarisë"!

Administrata Tatimore e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyes

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT DHE E SHKENCËS – PRIZREN

Datë: 21.06.2019
Nr. 1864/19

